



Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

DEPARTAMENTI PËR MONITORIM

Seksioni për Monitorim të Sistemit Juridik

Raporti Mujor- Shkurt 2008

Numri i pamjaftueshëm apo shpërndarja jo e barabartë e gjyqtarëve dhe prokurorëve, dhe objektet e papërshtatshme të gjykatave mund të qojnë në shkelje të ligjit vendor dhe standardeve për të drejtat e njeriut

I. Numri i pamjaftueshëm ose shpërndarja jo e barabartë e gjyqtarëve dhe prokurorëve

OSBE është e brengosur se numri i pamjaftueshëm ose shpërndarja jo e barabartë e gjyqtarëve dhe prokurorëve kontribuon në vonesa në rastet civile dhe ato penale.¹

Standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut parashohin se çdokush ka të drejtën për gjykim korrekt brenda kohës së arsyeshme.² Kjo garanci nënvizon “rëndësinë e ndarjes së drejtësisë pa vonesa të cilat mund të rrezikojnë efikasitetin dhe besueshmërinë e saj.”³ Është veçanërisht e rëndësishme për rastet penale në mënyrë që individët të mos “qëndrojnë[...] për kohë shumë të gjatë në gjendje të paqartësisë lidhur me fatin e tyre”.⁴ Kështu shtetet kanë për obligim t’i alokojnë mjetet e mjaftueshme financiare që janë në dispozicion të sistemit të tyre për administrim efektiv dhe të drejtë të gjyqësisë.⁵

Në linjë me këto standarde Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës⁶ parasheh që procedura penale të zhvillohet brenda kohës së arsyeshme, dhe që çfarëdo privimi nga liria të reduktohet në kohë sa më të shkurtë të mundshme.⁷ Për sa i përket procedurës civile, Ligji mbi Procedurën Kontestimore thotë që gjykata do ta zhvillojë procedurën pa ndonjë zvarritje të panevojshme.⁸

Aktualisht, ka 302 gjyqtarë të cilët punojnë në sistemin juridik dhe 20 vende të punës janë të lira. Për shembull, derisa Gjykata Supreme e Kosovës ka 16 pozita për gjyqtarë, aktiv aty janë vetëm 13 gjyqtarë. Në disa gjykata më të mëdha siç janë Gjykata e Qarkut

¹ Ngritja e pagave do të ndihmonte të tërheq kandidatët më të mirë që t’i plotësojnë këto pozita. Së paku, pagat në sistemin e drejtësisë duhet të jenë të krahasueshme me ato të kolegëve të tyre në degat e ekzekutivit dhe legjislativit. Edhe faktorë tjerë mund të kenë ndikim në shpejtësinë e zgjidhjes së lëndëve, siç është mungesa e numrit të mjaftueshëm të stafit përkrahës të gjykatave. Shih <http://www.ncscinternational.org/ks/news3.aspx>.

² Shih nenin 14(3) të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe nenin 6(1) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Konventa). Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka përcaktuar se arsyetimi i kohëzgjatjes së procedurës varet nga rrethanat e veçanta të rastit, duke përfshirë edhe ndërlikueshmërinë e rastit, sjelljen e të pandehurit dhe atë të autoriteteve kompetente administrative dhe gjyqësore (shih, p.sh., Aktgjykimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Konig v.Gjermany*, 6232/73, 28 korrik 1978, paragrafi 99).

³ Aktgjykimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *H. v France*, 10073/82, 24 tetor 1989, paragrafi 58.

⁴ Aktgjykimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Stogmuller v. Austria*, 10073/82, 10 nëntor 1969, paragrafi 5.

⁵ N. Mole, C. Harby, *E Drejta për Gjykim Korrekt. Udhëzues mbi Zbatimin e Nenit 6 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut*, edicioni i dytë, gusht 2006, faqe 7.

⁶ Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2003/26, 6 korrik 2003 (“Kodi i Procedurës Penale”).

⁷ Shih Kodin e Procedurës Penale, neni 5.

⁸ Neni 10 i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë Nr. 4/77, 1478, 36/80-1182, 69/82-1596.

në Mitrovicë/Mitrovica dhe Gjykata Komunale në Gjilan/Gnjilane, ka vende të lira pune (në të dy gjykatat mungojnë nga dy gjyqtarë). Por edhe mungesa e një gjyqtari të vetëm mund të ketë ndikim serioz në punën e gjykatës. Për shembull, Gjykata Komunale në Kamenicë/Kamenica ka vetëm dy gjyqtarë, përfshirë këtu edhe kryetarin, të cilët trajtojnë të gjitha rastet penale dhe civile.⁹

OSBE ka monitoruar disa raste kur gjykimet janë shtyrë për shkak të mungesës së gjyqtarëve dhe/ose prokurorëve:

Gjatë një interviste me monitorët e OSBE-së, një prokuror publik nga Mitrovicë/Mitrovica tha se deri vonë zyra e tij kishte pasur pesë prokurorë dhe një kryeprokuror të cilët mbulonin pesë gjykata komunale.¹⁰ Megjithatë, dy prokurorë kanë pranuar ngritje në detyrë për të punuar në prokurori të qarkut, duke lënë kështu në zyrë vetëm kryeprokurorin dhe tre prokurorë. Ky numër i prokurorëve është i pamjaftueshëm për t'i mbuluar pesë komuna, çdo njëra prej të cilave ka numër të konsiderueshëm të lëndëve. Një gjyqtar nga Gjykata Komunale në Mitrovicë/Mitrovica i tha OSBE-së se, për shkak të mungesës së prokurorëve atij i ishte dashur t'i shtyj disa gjykime të caktuara paraprakisht.

Në një rast në Gjilan/Gnjilane, me 28 qershor 2007 gjykata komunale është dashur ta shtyj seancën e gjykimit për shkak se prokurori i vetëm komunal ishte i zënë me seanca tjera të gjykimeve.

Në disa gjykata në Kosovë, duket se ka shumë numër të vogël të gjyqtarëve për t'i trajtuar lëndët që ndodhen në gjykata.¹¹

Për shembull, Gjykata për Kundërvajtje në Kaçanik/Kaçanik ka vetëm një gjyqtar për të trajtuar numrin prej përafërsisht 3.500 lëndëve në vit. Gjykata për Kundërvajtje në Dragash/Dragaš ka tre gjyqtarë për të trajtuar numrin prej përafërsisht 1.200 lëndëve në vit. Rrjedhimisht, ngarkesa me lëndë për një gjyqtar të gjykatës në Kaçanik/Kaçanik është pothuajse dhjetë herë më e lartë se sa në gjykatën në Dragash/Dragaš.¹²

⁹ Për më tepër, në secilën prej gjykatave në vijim, Gjykata e Qarkut në Pejë/Peć, dhe gjykatat komunale në Suharekë/Suva Reka, Malishevë/Mališevo, Dragash/Dragaš, Pejë/Peć, Gjakovë/Đakovica, Ferizaj/Uroševac dhe Vushtrri/Vučitrn, mungon nga një gjyqtar.

¹⁰ Mitrovicë/Mitrovica, Vushtrri/Vučitrn, Skenderaj/Srbica, Zubin Potok dhe Leposavić/Leposaviq.

¹¹ Bazuar në statistikat zyrtare të mara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Në fillim të vitit 2006, numri i rasteve të pazgjidhura në gjykata komunale ishte 143.776 raste, dhe në gjykata të qarkut 11.802 raste; si shtesë këtyre, gjykatat komunale pranuan 253.466 raste të reja gjatë vitit 2006, e gjykatat e qarkut 17.427. Të dhënat zyrtare për vitin 2007 nuk janë akoma në dispozicion.

¹² Të dhëna zyrtare nga raporti i Këshilli Gjyqësor të Kosovës mbi punën e gjykatave për kundërvajtje, 2006. Midis gjykatave për kundërvajtje më të ngarkuara me punë janë ato në Prishtinë/Priština (nëntë gjyqtarë, përafërsisht 3.800 lëndë brenda vitit për një gjyqtar) dhe në Ferizaj/Uroševac (pesë gjyqtarë, rreth 3.000 lëndë brenda vitit për një gjyqtar). Në kontrast, një gjyqtar në gjykatat për kundërvajtje në Zubin Potok, dhe Štrpce/Shtërpce ka ngarkesë prej më pak se 500 lëndë brenda vitit.

Mungesa e stafit është posaçërisht serioze në Gjykatën Komunale në Zubin Potok, ku ka vetëm një gjyqtar për t'u marrë me procedurën civile si dhe me atë penale, dhe që gjithashtu është edhe kryetare e gjykatës.¹³

Mungesa e stafit ndikon në mënyrë dramatike gjithashtu edhe në zyrat e prokurorive komunale. Në përgjithësi, prokurorët komunal janë të ngarkuar në gjykatat komunale të qarkut përkatës¹⁴ dhe jo në gjykatat përkatëse komunale me të cilat ata punojnë.¹⁵ Kështu atyre i duhet të udhëtojnë në gjykatën komunale kompetente kurdoherë që prezenca e tyre kërkohet. Për shkak të numrit të kufizuar të tyre, dhe mungesës së mjeteve të përshtatshme për transport, ata çdo ditë ballafaqohen me vështirësi në punën e tyre.

Numri i pamjaftueshëm ose shpërndarja jo e barabartë e stafit të gjykatave dhe prokurorive dërgon në zvarritje të lëndëve në zhvillim, madje edhe në rastet kur lënda është relativisht e thjeshtë. Kjo menjëherë mund të rezultojë në shkelje të së drejtës për gjykim brenda kohës së arsyeshme. Kështu, vendet e lira të punës duhet të plotësohen si çështje prioritare. Veç kësaj, Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet të marrë parasysh ngritjen e numrit të prokurorëve dhe gjyqtarëve dhe/ose ri-shpërndarjen e stafit ekzistues për t'u përputhur me ngarkesën ekzistuese të lëndëve.

II. Objektet e papërshtatshme të gjykatave

Në bazë të Parimeve Elementare të KB-ve mbi Pavarësinë e Gjyqësorit, secili shtet anëtar duhet të sigurojë resurse adekuate për t'i mundësuar gjyqësorit ta kryej funksionin e vet në mënyrë të duhur.¹⁶ Kjo përfshin edhe objektin e gjykatës siç janë gjykatoret dhe hapësira e zyrave.

Për më tepër, standardet ndërkombëtare parashohin se “çdo kush ka të drejtën për [...] dëgjim publik.”¹⁷ Ngjashëm, ligji vendor parasheh që shqyrtimi kryesor në procedurën penale dhe civile do të jetë i hapur për publikun.¹⁸ Megjithatë, publiku mund të përjashtohet nën disa rrethana të posaçme.¹⁹ E drejta për gjykim publik është aspekt

¹³ OSBE edhe më parë ka thënë se kjo situatë ndikon në të drejtën për gjykatë të themeluar në bazë të ligjit (shih Raportin Mujor, korrik 2006).

¹⁴ Veç kësaj, prokurorët komunal janë gjithashtu edhe në Ferizaj/Uroševac (që mbulojnë gjykatat komunale në Ferizaj/Uroševac dhe Kaçanik/Kaçanik), dhe Gjakova/Đakovica (vetëm Gjykata Komunale në Gjakovë/Đakovica).

¹⁵ Sipas disa kryetarëve të gjykatave, prokurorët duhet të caktohen për një gjykatë komunale specifike e jo të kenë nevojë të udhëtojnë gjithandej nëpër regjion.

¹⁶ Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 40/32, 29 nëntor 1985 dhe 40/146, 13 dhjetor 1985.

¹⁷ Neni 6(1) i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; Neni 14(1) i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike; Neni 10 i Deklaratës Universale mbi të Drejtat e Njeriut. Megjithatë, kjo e drejtë mund të kufizohet në interes të moralit, rregullit publik dhe sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, ku interesi i të miturve ose jetës private të palëve kërkon një gjë të tillë ose në rastet kur gjykata mendon se është gjithsesi e domosdoshme në rrethana të veçanta kur publiku do të mund të paragjykojë interesat e drejtësisë..

¹⁸ Neni 328(1), Kodi i Procedurës Penale; Neni 4, Ligji mbi Procedurën Kontestimore.

¹⁹ Nenet 328 deri 331 të Kodit të Kosovës të Procedurës Penale, dhe nenet 306 deri 310 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.

fundamental i standardeve për gjykim korrekt, për shkak se e bënë sistemin juridik të hapur për vlerësim të kujdesshëm publik. Kjo mbron që individët që ti mos nënshtrohen pushtetit arbitrar shtetëror.

OSBE është e brengosur që objektet e papërshtatshme të gjykatave në Kosovë mund të qojnë në shkelje të së drejtës për gjykim korrekt. Në fakt, në disa raste të monitoruara, për shkak të mungesës së sallave të gjykimit, publiku në disa seanca nuk ka pasur qasje.

Për shembull, në një rast të profilit të lartë ku përfshihej një i pandehur i ngarkuar me disa vepra penale²⁰ para kolegjit të përbërë prej gjyqtarëve ndërkombëtar pranë Gjykatës së Qarkut në Prishtinë/Priština me 6 korrik 2007, salla e gjykimit nuk mundte t'i zinte të gjithë pjesëtarët e publikut të cilët kishin dëshirë ta përcjellin seancën. Shumë prej tyre rrinin në këmbë brenda dhe jashtë sallës së gjykimit.

Në një tjetër rast pranë Gjykatës Komunale në Prizren, ku përfshihej një i pandehur i ngarkuar me veprën, sulm ndaj personit zyrtar,²¹ me 25 janar 2008 gjykata zhvilloi seancën e gjykimit në zyrën e kryetarit të kolegjit. Zyra ishte aq e vogël sa që nuk i zinte disa të afërm të të pandehurit të cilët kishin dëshirë ta përcjellin seancën, dhe ata qëndruan në korridor.

Brengosës është fakti se, në një rast, mungesa e hapësirës rezultoi me shkelje të së drejtës për t'u gjykuar në prezencë.²²

Në një rast pranë Gjykatës për Kundërvajtje në Pejë/Peć, që përfshinte procedurë kundër 13 të pandehurve të ngarkuar më veprën, prishje e rendit dhe qetësisë publike, gjykata mbajti seancë me 18 qershor 2007. Megjithatë, zyra e gjyqtarit ishte aq e vogël sa nuk kishte mundësi t'i zë të gjithë të pandehurit. Kështu, gjyqtari e mori secilin të pandehur individualisht në pyetje dhe pastaj kërkoi nga ata ta lirojnë dhomën. Kjo shkeli të drejtën për gjykim në prezencë.

OSBE vërejtë se në shumë gjykata komunale dhe ato për kundërvajtje, gjyqtarët i mbajnë seancat e gjykimit në zyrat e tyre. Madhësia e kufizuar e këtyre zyrave nuk lejon që publiku të merr pjesë. Shpesh, e gjithë hapësira e zyrës zihet nga gjyqtari(ët), personeli i gjykatës, palët dhe përfaqësuesit e tyre ligjor.

Pos mungesës së hapësirës në salla të gjykimit dhe zyra të gjykatës, gjykatat dhe zyrat e prokurorisë shpesh nuk kanë pajisjet e nevojshme për t'i kryer përgjegjësitë e tyre.

Për shembull, gjykatave dhe prokurorive shpesh u mungojnë mjetet elementare siç janë lapsat, letrat dhe tonerët për shtypës,²³ ndërsa makinat për fotokopjim shpesh nuk

²⁰ Pjesëmarrja në grup që pengon personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, neni 318(1) Kodi Penal; Pjesëmarrja në grup që kryen vepra penale, neni 320(1) Kodi Penal; dhe Thirrja për rezistencë, neni 319(1) Kodi Penal.

²¹ Neni 317(2), Kodi Penal.

²² Shih Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, neni 14(3).

²³ Prokuroria e Qarkut dhe ajo Komunale në Prizren, Gjykata Komunale në Pejë/Peć.

funksionojnë.²⁴ Kjo jo vetëm që zvarrit punën e tyre por mund të paraqet edhe shkelje të së drejtës për qasje në dokumente publike.²⁵ Shpeshherë, kompjuterët, makinat për shtypje si dhe ato të faksit janë të vjetra dhe nuk funksionojnë. Pasi që gjykatave u mungon karburanti për gjeneratorë, seancat e gjykimeve duhet të shtyhen shpesh për shkak të shkëputjeve të energjisë elektrike.²⁶

Së fundi, disa zyra të prokurorive komunale kanë në dispozicion vetëm një veturë për transport të prokurorëve në gjykatat komunale të rajonit. Si pasojë, prokurorët nuk mund të paraqiten në të gjitha dëgjimet penale në të cilat duhet të marrin pjesë. Kjo shkakton vonesa të panevojshme në procedurat penale, dhe përfundimisht mund të rezultojë me shkelje të së drejtës për gjykim brenda kohës së arsyeshme.²⁷

Rrjedhimisht, OSBE rekomandon:

- Si çështje prioriteti, Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet t'i plotësojë pozitat e lira për gjyqtarë dhe prokurorë, dhe të vlerësojë se a duhet të rritet numri i gjyqtarëve dhe prokurorëve apo të bëhet ri-shpërndarja e tyre në mënyrë për të menaxhuar numrin e lëndëve ekzistuese.
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Ministria e Drejtësisë dhe Qeveria e Kosovës duhet bashkërisht të sigurohen që sistemi i drejtësisë i Kosovës të ketë fonde të mjaftueshme për t'i kryer përgjegjësitë e veta. Sistemi i drejtësisë i Kosovës duhet të ketë objekte për të mbajtur gjykime publike, hapësirë të mjaftueshme për zyra dhe pajisje të nevojshme.

²⁴ Në Gjykatën Komunale në Prishtinë/Priştina, ka vetëm dy makina për fotokopjim të cilat shpesh nuk funksionojnë. Në degën e Gjykatës Komunale të Prishtinës/Priştina në Gračanica/Graçanicë, nuk ka makinë për fotokopjim. Prokuroria e Qarkut në Prishtinë/Priştina, për muaj me radhë ka pasur probleme me makinën për fotokopjim dhe përdornin makinën e vogël të faksit për të fotokopjuar. Gjykatat e qarkut dhe ato komunale në Mitrovicë/Mitrovica, nuk kanë makinë funksionale për fotokopjim, dhe e përdorin atë të gjykatës për kundërvajtje.

²⁵ Shih Rregulloren e UNMIK-ut 2003/32, *Mbi Shpalljen e Ligjit të adoptuar nga Asambleja e Kosovës mbi Qasjen në Dokumente Zyrtare*, me 6 nëntor 2003.

²⁶ Për shembull, kjo ka ndodhur në Gjykatën Komunale në Pejë/Peć.

²⁷ Neni 6(1), Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.